

Policia e Kosovës njofton se gjatë ceremonisë së sotme për inaugurimin e presidentit Hashim Thaçi, disa persona kanë gjuajtur me gaz lotsjellës afër lokacionit ku ishte paraparë të zhvillohet ceremonia.

"Në rrugën 'Agim Ramadani', në rrugën 'Bajram Kelmendi' dhe në disa lokacione tjera në atë perimetër, persona të dyshuar kanë hedhur gaz lotsjellës, me qëllim të pengimit të ceremonisë, e cila është realizuar pa probleme sipas planifikimeve dhe protokollit të paraparë", thuhet në njoftimin e Policisë.

Njësitët policore kanë reaguar menjëherë dhe disa nga të dyshuarit janë gjetur dhe janë ndaluar, në tentativë duke u përpjekur të hedhin gaz lotsjellës, përderisa një zyrtar policor ka pësuar djegie në dorë gjatë përpjekjeve për të parandaluar veprimet e kundërligjshme të personave të dyshuar.

Policia e Kosovës ka ndërmarrë veprimet e saj ligjore për garantimin e rendit dhe sigurisë së përgjithshme, ku personat e dyshuar të involvuar në këto veprime joligjore janë arrestuar, përderisa në stacion policor për intervistim janë shoqëruar dymbëdhjetë (12) persona të dyshuar.

Në cilësi të provave materiale janë konfiskuar disa copë mbetje të gazit lotsjellës të përdorur, katër copë gazi lotsjellës të papërdorur, tri shkrepësa si dhe një mjet për hedhje të gazit lotsjellës, të cilat janë gjetur tek disa nga personat e dyshuar.

Të gjitha veprimet e mëtutjeshme policore lidhur me personat e dyshuar do të ndërmerren në konsultim me prokurorin kompetent.